

RAPORT MONITORIMI

“VEPRIMTARIA DHE VIGJILENCA E INSTITUCIONEVE NË LUFTËN NDAJ LËNDËVE NARKOTIKE”

Tiranë, më 9 Shkurt 2021



Periudha e monitorimit: 3 muaj

Nëntor 2020 – Janar 2021

1. HYRJE

Ky raport monitorimi 3 mujor¹ u bë i mundur pas përpilimit të metodologjisë së analizimit dhe vlerësimit të të dhënave të grumbulluara nga ekspertët në terren, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet penale pjesë e mekanizmit të sistemit të drejtësisë. Këto të dhëna u reflektuan në një platformë (databazë) të krijuar për monitorimin e disa veprave penale.

Nëpërmjet raporteve mujore, mbi elementë të ndryshëm të veprave penale, por duke pasur në fokus subjektin e kryerjes së tyre, Qendra “Fol”, synon të informojë publikun e gjerë rreth të dhënave statistikore dhe cilësore, si dhe rreth qasjes që institucionet publike reflektojnë në momentin e ndjekjes, hetimit dhe gjyqimit të autorëve të dyshuar.

Ky raport i I-rë monitorimi reflekton të dhëna mbi kategorinë e figurave të veprave penale që janë pjesë e Kreut VIII “Krimet kundër autoritetit të shtetit”, Seksioni III “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, të cilat janë mishëruar nga ana e ligjvënësit në dispozita materiale penale nenet 283, 283/a, 283/b, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 285/a, 285/b dhe 286 të Kodit Penal.

Qendra “Fol” dëshiron të falenderojë Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, institucionet kyçe që luajtën një rol të rëndësishëm në implementimin e iniciativës “Fol për Drejtësinë” si Policia e Shtetit, Prokuroritë pranë të dyja shkallëve të gjyqimit Tiranë dhe përfaqësuesit e sistemit gjyqësor, që ushtrojnë funksionin pranë Gjykatave penale të të gjitha shkallëve të gjyqimit në Tiranë, si dhe ekspertët e angazhuar në terren në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave.

2. Të dhënat e grumbulluara dhe të analizuara nga ekspertët e Qendrës “Fol”

Të dhënat e grumbulluara nga ekspertët i korrespondojnë periudhës kohore **Nëntor 2020 – Janar 2021**. Këto të dhëna i korrespondojnë shtetasve të proceduar penalisht, të hetuar dhe të gjykuar nga institucionet penale pjesë e mekanizmit të drejtësisë në rrethin Tiranë.

Nga të dhënat e grumbulluara nga ana e ekspertëve rezulton se **303 shtetas** janë proceduar penalisht si të dyshuar për kryerjen e veprave penale në fushën e drogërave, në qarkun Tiranë. Ekspertët konstatojnë se ky numër është i lartë, duke marrë parasysh moshën e re të të dyshuarve, faktin se disa prej tyre janë recidivistë, si dhe përfshirjen në masë të shtuar të shtetasve të gjinisë femërore.

Nga të dhënat e grumbulluara nga ekspertët rezulton se në pjesën më të madhe të rasteve kur Policia ka konstatuar posedimin e një sasive të vogël të lëndës narkotike i ka referuar në gjendje të lirë të dyshuarit. **Më konkretisht gjatë periudhës 3 mujore janë referuar në gjendje të lirë 229 shtetas ose rreth 76%, ndërkohë që 74 shtetas ose rreth 24% e tyre janë arrestuar nga ana e Policisë. Nisur nga analiza e rrethanave të faktit pjesa më e madhe e këtyre shtetasve deklarojnë se janë përdorues të lëndës narkotike, por referimi në gjendje të lirë realizohet edhe për faktin se janë mbajtës ose përdorues të lëndës narkotike të llojit “hashash”, të konstatuar në sasira të vogla. Nga kampioni i**


¹ Të dhënat e reflektuara në këtë raport i përkasin periudhës 1 Nëntor 2020 deri më 30 Janar 2021.

Ky raport monitorimi u realizua në zbatim të nismës “Fol për Drejtësinë”, zbatuar nga Qendra Fol, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Të dhënat, gjetjet dhe opinionet e reflektuara në këtë raport, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Ambasadës së SHBA-ve, dhe janë autorësi ekskluzive e Qendrës Fol.

studimit, ka rezultuar se ka pasur raste të shtetasve përdorues, të cilët në momentin e ndalimit nga Policia janë referuar në gjendje të lirë sa i takon mbajtjes ose përdorimit të lëndës narkotike, por janë dërguar në gjyq për shkak të përdorimit të mjetit në gjendje të dehur.

Nga **303** rastet e monitoruara gjatë periudhës 3 mujore, për 202 shtetas ose **67%** e tyre, Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Për këto çështje të mosfilluara nuk është regjistruar asnjë ankim në Gjykatë. Interesant shfaqet rasti i një shtetasi të arrestuar në flagrancë për drejtim mjeti në gjendje të dehur, ndërkohë që gjatë kontrollit fizik është konstatuar mbajtës i një sasive prej **0.7 gr.** kokainë. Është referuar në gjendje të lirë përsa i përket mbajtjes ose përdorimit të lëndës narkotike, ndërkohë që për veprën penale të parashikuar nga neni 291 K.P. ‘Drejtim mjeti në gjendje të parregullt’ çështja është dërguar në Gjykatë. Masa e sigurimit personal e kërkuar nga ana e Prokurorit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, është lënë në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Vlen të mbahet parasysh se **33%** e rasteve janë ende në pritje të vendimmarrjeve të prokurorëve, të cilat varen nga rezultatet e testeve toksikologjike dhe kimike që analizohen nga Instituti i Mjekësisë Ligjore. Sasia përkatëse e lëndës narkotike që ngarkon ose përjashton nga përgjegjësia penale një shtetas është e përcaktuar në përputhje me nenin 283/1 K.P. dhe kriteret e parashikuara në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 27.03.2008.



persona vetëm për muajin Janar 2021).

Të dhënat e grumbulluara nga ana e ekspertëve në terren tregojnë se muaji Nëntor 2020 përbën muajin, gjatë të cilit është proceduar numri më i lartë i shtetasve. Gjatë këtij muaji rezultoi se **125** persona janë proceduar personalisht, duke përbërë **41%** të të dhënave totale të konstatuara në terren. Ndërkohë që muaji Dhjetor 2020 pasohet me **110** persona të proceduar penalisht, duke pasqyruar **36%** të numrit total të shtetasve të proceduar gjatë 3 mujorit. Muaji Janar 2021, deri në ditën e vlerësimit të të dhënave nga ana e ekspertëve përbëhet nga **23%** të numrit total prej **303** personash të proceduar (ose 68

KATEGORIZIMI I VEPRAVE PENALE

1. Referimi i shtetasve të dyshuar për prodhim dhe shitja të narkotikëve sipas nenit 283 Kodit Penal


Nga **303** shtetas të referuar nga shërbimet policore në qarkun Tiranë, **189** prej tyre janë proceduar për nenin 238 të Kodit Penal. Konkretisht për **155** prej tyre (rreth 51% e numrit total) rezultojnë të jenë proceduar penalisht gjatë muajve Nëntor – Dhjetor 2020, për veprën penale të parashikuar në nenin 283 K.P. “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”. Ndërkohë në muajin Janar 2021, numërohen **34** shtetas (rreth **11%** e numrit total), në ngarkim të të cilëve është regjistruar një procedim penal për të njëjtën veprë penale.

2. Referimi i shtetasve sipas nenit 283/1 Kodit Penal.

Referuar mënyrës dhe formës së kryerjes së veprës penale (*modus operandi*), rezulton se **92** shtetas të tjerë ose rreth **30%** janë proceduar penalisht si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 283 K.P., kryesisht në formën e shitjes, mbajtjes ose shpërndarjes së lëndës narkotike. Përkatësisht gjatë vitit 2020, numërohen **63** shtetas ose rreth **21%** e numrit total të shtetasve, ndërkohë gjatë janarit 2021 numërohen **29** shtetas ose rreth **10%**. Ndaj **68** shtetasve të proceduar penalisht sipas nenit 283/1 K.P., rezulton se është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga ana e prokurorit me argumentin se rezultojnë përdorues, ndërkohë që masa e sigurimit “arrest në burg” është kërkuar nga ana e Prokurorit për 7 shtetas. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” është kërkuar nga ana e Prokurorit vetëm për 1 rast, për 1 shtetas i cili është proceduar penalisht edhe për veprën penale të “Dhunës në familje” (neni 130/a K.P.). Kjo masë sigurimi është lënë në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Ndaj **16** shtetasve ose rreth **5%** të proceduar penalisht sipas nenit 283/1 K.P., prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” (sipas nenit 234 K.Pr.P.). Kjo masë sigurimi është lënë në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, Dhoma Penale Tiranë. 2 prej këtyre shtetasve të proceduar për këtë veprë penale janë me shtetësi të huaj.

Organi procedues ka ndjekur qasjen e regjistrimit të veprës penale sipas figurave të ndryshme të saj, për shkak dhe të provave në dispozicion në momentin fillestar të referimit nga ana e organeve të rendit. Si rrjedhojë, konstatohet një diferencim i regjistrimit të të dhënave sipas paragrafëve të përcaktuar në nenin 283 K.P., në varësi të rrethanave të faktit të regjistruar për secilin rast.



3. Referimi i shtetasve të dyshuar për mbajtjen, shitjen ose shpërndarjen e lëndës narkotike në formën e bashkëpunimit, sipas nenit 283/2 Kodit Penal.

Rezulton se **12** shtetas gjate periudhës nëntor 2020- janar 2021 janë proceduar penalisht sipas nenit 283/2 K.P., në formën e bashkëpunimit ose kryerjes së veprës penale më shumë se një herë. Pjesa më e madhe e këtyre shtetasve janë arrestuar në flagrancë, ndërkohë që përvec lëndës narkotike hashash janë posedues të lëndës narkotike të llojit kokainë. Së bashku me nenin 283/2 **3** prej këtyre shtetasve janë proceduar penalisht edhe për nenin 279 K.P.”Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”. 1 prej këtyre shtetasve është arrestuar së bashku me bashkëshortjen e tij, ndërkohë që masa e sigurimit e kërkuar ndaj tij nga ana e Prokurorit është “arrest në burg” sipas nenit 238 K.Pr.P.

4. Referimi i shtetasve të dyshuar për krijimin e lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës , sipas nenit 283/b i Kodit Penal.

Nga të dhënat e grumbulluara nga ekspertët në terren rezulton se figura e veprës penale të “Krijimit të lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës”, të parashikuar nga neni 283/b K.P., gjatë muajve nëntor- dhjetor 2020 nuk ka asnjë rast të evidentuar. Gjate muajit janar 2021 konsatohet 1 çështje hetimore . **2** shtetas rezultojnë të jenë referuar si të dyshuar për kryerjen e kësaj vepre penale përkatësisht neni 283/2 i Kodit Penal. 1 prej shtetasve e gjinisë femërore është referuar në gjendje të lirë, ndërkohë që shtetasi tjetër është arrestuar pasi është gjetur se ka përshtatur lokalitë në pronësinë e tij në ambient për konsum dhe përdorim lëndësh narkotike. Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për këtë shtetas, ndërkohë që kjo masë siguri është lënë në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë.

5. Referimi i shtetasve të dyshuar për kultivim të bimëve narkotike , sipas nenit 284 i Kodit Penal.

Gjate muajit nëntor 2020 , konstatohet një hetim me **8** shtetas të proceduar të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284 K.P. Ndaj **7** prej tyre, prokurori i ngarkuar ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, ndërkohë që ndaj vetëm **1** prej tyre është kërkuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi”. Të gjitha masat e sigurimit janë dhënë në mungesë të të pandehurve, të përfshirë në të njëjtën ngjarje kriminale. Ky i fundit rezulton i bashkë-pandehur, pjesë e një familjeje anëtarët e së cilës përfshihen në grupin e sipërcituar. Masa e sigurimit e kërkuar nga ana e prokurorit, u la në fuqi edhe nga ana e dy shkallëve të gjyqimit, ndërkohë që për këtë çështje masat e sigurimit personal të shpallura në mungesë u ndryshuan ,më pas nga gjykata. Rezulton se vetëm ndaj **3** personave pjesë e grupit, dy shkallët e gjyqimit penal lanë në fuqi masën e sigurimit “arrest në burg”. Edhe pse ishin të akuzuar si të bashkë-pandehur, sistemi gjyqësor vendosi lehtësimin e pozitës procedurale për **3** prej tyre, duke caktuar masën e sigurimit me vendim të formës së prerë “arrest në shtëpi”. Ndërsa për 2 të tjerë u vendos detyrim paraqitje

Gjatë muajve dhjetor 2020 dhe janar 2021 nuk u konstatua asnjë referim tjetër për këtë vepër penale

MASAT E SIGURIMIT


1. Masa e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”

Qasja e prokurorisë për masën ‘detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore’ sipas nenit 234 K.Pr.P nga volumi I çështjeve të monitoruara renditet si vijon

Për vitin 2020 ndaj **37** personave, është kërkuar nga ana e Prokurorit caktimi i kësaj mase sigurimi. Prej tyre, **8** shtetas konstatohen të proceduar gjatë muajit Nëntor 2020 dhe **19** shtetas të proceduar gjatë muajit Dhjetor 2020. Për janarin 2021, duke marrë parasysh dhe numrin e ulët të shtetasve të proceduar, rezulton se Prokuroria ka kërkuar caktimin e kësaj mase sigurimi vetëm ndaj **10** shtetasve. Referuar figurës së veprës penale, për të cilën dyshohen se kanë kryer, rezulton se **15** shtetas ose rreth **41%** e numrit total të shtetasve të referuar nën këtë masë sigurimi, janë proceduar për veprën penale të parashikuar sipas nenit 283 K.P.”Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”. Ndërkohë që **16** shtetas ose rreth **43%** dyshohen si autor të veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 K.P., **5** shtetas sipas nenit 283/2 K.P. nën rrethanën cilësuese të bashkëpunimit ose më shumë se një herë.

2. Masa e sigurimit “Arrest në burg”

Sa i takon masës së sigurimit “arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 K.Pr.P. gjatë muajve Nëntor – Dhjetor 2020 rezulton se:



Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “**arrest në burg**” ndaj **28** shtetasve, ndërkohë që Gjykata Penale e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e prokurorit duke caktuar këtë masë për **19** persona. Për **9** shtetas të tjerë Gjykata Penale e Shkallës së Parë ka vendosur vendosur masën e detyrimit me paraqitje. Nga **19** masa arresti, Gjykata e Apelit la në fuqi këtë masë të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për **12** persona. Ndryshim të masës së sigurimit “arrest në burg” nga ana e

Gjykatës së Apelit u konstatua vetëm për **3** shtetas. Gjatë monitorimit për muajt nëntor 2020- janar 2021, janë konstatuar raste në të cilat kërkesa e prokurorit për caktimin e kësaj mase sigurimi nuk ka qenë e mbështetur në prova bindëse dhe tejet çdo dyshimi të arsyeshëm, duke detyruar gjykatat që të caktojnë ekzekutimin e masës së sigurimit për një periudhë të caktuar kohe. Kjo periudhë e caktuar kohore ngre premisa për cënim të të drejtave të shtetasve të dyshuar, përsa kohë që ata qëndrojnë nën kushtet e privimit të lirisë, ndërkohë që organi procedues pozicionohet në rol “avantazhues” duke mbledhur indicie dhe prova shtesë, që mund të rëndojnë pozitën procedurale të individit. Interesant për t’u analizuar është rasti i 1 shtetasi, ndaj të cilit gjykatat e dy shkallëve të gjykimit kanë miratuar kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për një afat të caktuar kohor. Në përfundim të këtij afati, shtetasi ka depozituar kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, por ndërmjet dy gjykatave është konstatuar një konflikt kompetence, duke bërë që shtetasi të qëndrojë në kushtet e privimit të lirisë tejet afatit të caktuar fillimisht.



Gjatë vitit **2021**, rezulton se Prokuroria ka kërkuar ndaj **9** shtetasve caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, ndërkohë që Gjykata Penale e Shkallës së Parë ka aprovuar kërkesën e depozituar nga ana e prokurorit duke caktuar këtë masë sigurimi vetëm ndaj **7** personave. 1 prej këtyre shtetasve rezulton i mitur, ndërkohë që bie në sy fakti se pjesa më e madhe e këtyre shtetasve të kapur me drogë janë recidivistë, ose në kërkim nga ana e Policisë së Shtetit për kryerjen e veprave penale të vjedhjes, vrasje me paramendim ose armëmbajtje pa leje.

3. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi”

Organi procedues rezulton se vetëm gjatë muajve Nëntor – Dhjetor 2020 ka depozituar **5** kërkesa për caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, ndërkohë që në vitin 2021 asnjë kërkesë me këtë objekt nuk rezulton të jetë depozituar. Gjykata Penale e Shkallës së Parë Tiranë ka miratuar kërkesën e depozituar nga ana e Prokurorit, duke lënë në fuqi masën e arrestit në shtëpi për **4** persona, kurse Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi këtë masë vetëm për 1 person.


Dhoma Penale e Gjykatës së Shkallës së Parë nuk ka ndjekur gjithmonë të njëjtën qasje të organit procedues, duke miratuar kërkesën për caktimin e masës së sigurimit të referuar nga ana e prokurorit. Në 1 rast ku shtetasi dyshohet për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenin 283 K.P.”Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, ndërkohë që Prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, dy shkallët e gjykimit kanë vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Kjo vendimmarrje e të dyja shkallëve të gjykimit bie ndesh me pikën 3 të nenit 244 të K.Pr.P., në të cilën është përcaktuar se “Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori”.

4. Mosfillimi i procedimit penal nga ana e Prokurorit, në shifra të larta gjatë muajve Nëntor-Dhjetor 2020. Cilët janë elementët ndikues?

Brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit, prokurori në rast se konstaton se ndodhemi përpara rrethanave të mosfillimit të procedimit penal, mund ta vendosë atë me vendimmarrje të arsyetuar. Por si paraqitet situata e vendimmarrjeve të prokurorisë për mosfillimin e procedimeve në fushën e drogërave dhe lëndëve narkotike?

Pyetjes së mësipërme i japin përgjigje të dhënat e analizuar në mënyrë objektive dhe të gjithanshme nga ana e ekspertëve. Nga të dhënat e grumbulluara në terren rezulton se në asnjë rast ndaj vendimmarrjeve të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal, nuk është ushtruar e drejta e ankimit e parashikuar në nenin 291/2 K.Pr.P, për t’ja nënshtruar këtë vendimmarrje kontrollit gjyqësor.

Gjatë muajve Nëntor – Dhjetor 2020 rezulton një shifër më e lartë e vendimmarrjeve për mosfillimin e procedimeve penale, ndërkohë që në muajin Janar 2021 vetëm 35 raste konstatohen të jenë konkluduar me një vendimmarrje të tillë. Gjatë muajve Nëntor – Dhjetor 2020, prokurorët pranë Prokurorisë së Tiranë kanë marrë vendim në 167 raste për mosfillimin e procedimit penal.



Ndër këto 145 shtetas ose rreth 72% të proceduar penalisht si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar në neniin 283 K.P.”Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, ndërsa 57 shtetas ose rreth 28% të referuar sipas nenit 283/1 K.P. në formën e shitjes, shpërndarjes ose mbajtjes së lëndës narkotike. Vlen të evidentohet të gjithë shtetasit subjekte të

vendimmarrjeve të mosfillimit nga ana e prokurorisë, janë referuar në gjendje të lirë nga ana e Policisë së Shtetit. Arsye kryesore në pjesën më të madhe të këtyre vendimmarrjeve, referohet fakti se shtetasit e dyshuar kanë rezultuar përdorues të lëndës narkotike, provuar edhe nëpërmjet rezultateve të testeve kimike e toksikologjike të cilave iu janë nënshtruar. Nga vendimmarrjet janë konstatuar raste të shtetasve recidivistë në kryerjen e kësaj vepre penale dhe/ose në kërkim si të dyshuar për kryerjen e veprave të tjera penale, ndërkohë që në pjesën më të madhe rezulton se lloji i lëndës narkotike e cila është konstatuar gjatë kontrollit fizik është hashash në sasi të vogla për konsum vetjak.

5. Harta ku u konstatuan me lëndë narkotike gjatë muajve nëntor 2020 – janar 2021

Ekspertët vlerësojnë se zonat e lokalizuara janë të populluara dhe të frekuentuara nga mosha të ndryshme, kryesisht të rinj, duke shërbyer si këmbanë alarmi për forcat e rendit. Gjithashtu, një tjetër element shqetësues janë shumatat e deklaruara, për blerjen e lëndës narkotike, të cilat pasqyrojnë shifra të vogla, duke bërë që të jenë të përballueshme edhe nga familje me gjendje socio-ekonomike të ulët ose mesatare. Këto zona (pa u kufizuar) janë:



1. Zona e Selvisë
2. Rr. Dritan Hoxha
3. Rr. Muhamet Gjollësia
4. Sheshi Skënderbej
5. Rr. Kodra e Priftit
6. Rr. Lord Bajron
7. Rr. Serafin Fanku (Shkozë)
8. Rr. Tish Daija
9. Rr. Aleksandër Moisiu
10. Rr. Shemsi Haka
11. Rr. Him Kolli
12. Astir, Kinostudio, Fresku
13. Pazari i Ri
14. Rr. Don Bosko
15. Blv “Gjergj Fishta”
16. Rr. Gjin Bue Shpata
17. Rr. Egnatia
18. Rr. Frang Bardhi
19. Rr. Ana Komnena
20. Zona Pallati me Shigjeta
21. Rr. Grigor Heba
22. Laprakë (katrori)
23. 21 Dhjetori
24. Rr. Ali Demi etj.